

VENDIM
Nr. 269, datë 11.9.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR
APLIKIMIN E SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS
PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SELCA”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1974/6 prot., datë 8.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë ‘Selca Energji’ sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC ‘Selca’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Selca Energji” sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010, i ndryshuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.7.2023, paraqiti aplikimin për modifikimin e licencës, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selca” nga 1,6 mw në 1,98 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 9.8.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., me vendimin nr. 39/2010, i ndryshuar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 10.8.2023 dhe 11.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1974/3 prot., datë 18.8.2023, ERE iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për dijeni shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., duke kërkuar qëndrimin e MIE-s mbi mënyrën e trajtimit të kërkesës për modifikim licence në ERE, në kuadër të shtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara. Nga MIE nuk ka ende një përgjigje lidhur me kërkesën e ERE.

- ERE me shkresën nr. 1974/4 prot., datë 22.8.2023, i njoftoi shoqërisë mbi marrjen e vendimit nr. 245/2023 dhe evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974/5 prot., datë 24.8.2023, shoqëria “Selca Energji” sh.p.k. ka ritheksuar se Hidrocentrali i Selcës është një HEC ekzistues (ndërtuar në vitin 1968) i privatizuar, në pronësi të shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. Shoqëria nuk ka një kontratë koncensionale me Ministrinë e Energjisë pasi Hidrocentrali është i privatizuar në pronësi të shoqërisë dhe në këto rrethana nuk ka detyrime ligjore raportuese apo varësie ndaj këtij institucioni. Po ashtu, shoqëria ka dokumentuar në format fotokopje miratimin për shtesën e kapacitetit për lidhjen me rrjetin e sistemit të shpërndarjes nga OSSH sh.a. në të cilën nuk paraqitet ndryshim në skemën e lidhjes.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 15 “Modifikimi i licencës”,

Pika 4

- **germa “d”:** miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara;

- **germa “e”**: miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi rritjen e kapacitetit të instaluar;

germa “f”: miratimin/qëndrimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në rast se leja për përdorimin e burimit ujqor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”, me kapacitet të shtuar prej 380 kw.

- Në zbatim të nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: “...ERE merr në konsideratë ndikimet e pritsbme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij”, si dhe nenit 53, pika 2 e “Kodit të Procedurave Administrative”, i cili përcakton se: “2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

- Me qëllim marrjen e një miratimi/qëndrimi të mundshëm nga MIE për kërkesën e dërguar nga ERE dhe marrjen e një miratimi/qëndrimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU), në lidhje me rritjen e kapacitetit të HEC-it “Selca” me 380 kw, vlerësohet të zgjatet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Selca Energji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti